

KONKURS

Instituti ATOMI, me përkrahje nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe me autorizimin e Asociacionit Kangourou Sans Frontières (AKSF), organizon Garën Ndërkombëtare të Matematikës Kangaroo – 2019 (Math Kangaroo Contest – Kosovo - MKC-K) në Kosovë. Kangaroo është konkursi më i popullarizuar në botë për matematikë, që ka për qëllim promovimin dhe popullarizimin e matematikës, si dhe përkrahjen e talenteve të fushës së matematikës. Në vitin 2018, në tërë botën kanë marrë pjesë mbi 6 milionë nxënës nga mbi 70 shtete të ndryshme të botës. Me **23 mars 2019** të gjithë nxënësit e shkollave publike dhe private të Republikës së Kosovës mund të marrin pjesë në këtë konkurs. Në fund të gjithë nxënësit pjesëmarrës do të pajisen me Certifikata të pranura ndërkombëtarisht, që pasqyrojnë rezultatin e tyre në këtë test.

KUSH MUND TË APLIKOJË?

Të gjithë nxënësit e Republikës së Kosovës prej klasës II deri XII, pa marrë parasysh suksesin e tyre nga matematika.

PËRFITIMET E MUNDSHME PËR MË TË SUKSESSHMIT:


- Shpërblime të ndryshme;
- Kurse dhe trajnime të avancuara (falas) nga profesionistët e matematikës;
- Mentorim nga profesionistët e matematikës;
- Qasje në literaturë të avancuar të matematikës;
- Mundësi pjesëmarrjeje në gara ndërkombëtare
- Certifikim i njohur ndërkombëtarisht;
- Bursa shkollimi në shkollat cilësore të Kosovës

PËR TË APLIKUAR:

Në faqen e internetit të MKC-K (www.kangaroo-ks.org) mund të merrni informatat shtesë për aplikim, përfshirë kontaktin e koordinatorëve rajonalë. Afati i aplikimit zgjatë deri më 3 mars 2019. Testimi do të mbahet të shtunën, më **23 mars 2019**. Aplikantët do të informohen me kohë përmes faqes së internetit dhe faqes së fejsbukut të MKC-K-së për kohën dhe vendin e mbajtjes së testimit.

Shembuj detyrash nga viti 2018

Klasat 1-2. Kjo picë është ndarë në pjesë të barabarta. Sa pjesë janë hequr nga pica?



- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5

Klasat 3-4. Kjo është figura e mollëkuqes Dua . Ajo bën një lëvizje. Cila figurë nuk mund të jetë mollëkuqja Dua?



(A)



(B)



(C)



(D)




(E)


Klasat 5-6. 3. Herën e parë Diana arriti gjithsej 14 pikë me dy shigjeta. Herën e dytë ajo arriti 16 pikë. Sa pikë arriti ajo në herën e tretë?



14 pikë



16 pikë



???

- (A) 17 (B) 18 (C) 19 (D) 20 (E) 22